



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Arsim

Uprava za Obrazovanje//Department of Education

Nr.Prot:05/ 155

Datë: 11.02.2026

Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime, në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, në bazë të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores (QRK) Nr. 19/2024, pas shqyrtimit të dokumentacionit zyrtar të procedurës së rekrutimit me numër reference 02-111/01-0003071/26, datë 04.02.2026, të zhvilluar për pozitën një (1) mësimdhënës për lëndët në drejtimin Bujqësi, profili Agrobiznes, me 13 orë mësimore, në Institucionin për Arsim dhe Aftësim Profesional në Shtime, nxjerr këtë

VENDIM

Shpallet e dështuar procedura e rekrutimit me numër reference 02-111/01-0003071/26, datë 04.02.2026, për pozitën një (1) mësimdhënës për lëndët në drejtimin Bujqësi, profili Agrobiznes, me 13 orë mësimore, në Institucionin për Arsim dhe Aftësim Profesional në Shtime.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij dhe kundër tij mund të ushtrohen mjetet juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Arsyetimi

Nga dokumentacioni i procedurës së rekrutimit konstatohet se në konkurs ka aplikuar vetëm një (1) aplikues. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur dhe shqyrtimit të kushteve të përcaktuara në konkurs, është konstatuar se aplikuesi nuk posedon kualifikimin adekuat për pozitën e shpallur.

Duke qenë se nuk ka pasur kandidatë të tjerë dhe kandidati i vetëm nuk i plotëson kriteret e përcaktuara, procedura e rekrutimit konsiderohet e pasuksesshme dhe, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 që rregullojnë rastet e dështimit të procedurës së rekrutimit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Një kopje i dorëzohet:

Njësisë së Burimeve Njerëzore

